

Gjuan me armë, arrestohet një person në Viti

FaktePlus 27/05/2019, 11:18



Një person është arrestuar në Viti, pasi që i njëjti dyshohet të ketë shtënë me armë zjarri.



Të dyshuarit i është konfiskuar një pistoletë me një karikator, kurse sic njofton Policia e Kosovës në raportin 24 orësh në vendin e ngjarjes janë gjetur e konfiskuar tri gëzhoja të fishekëve.

Ndërkaq, pas intervistimit, me urdhër të prokurorit i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

“Është arrestuar i dyshuari mashkull K/Shqiptar pasi që i njëjti dyshohet se ka shtënë në ajër me armë zjarri. Nga i dyshuari është konfiskuar një pistoletë me një karikator, ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe janë konfiskuar tri gëzhoja të fishekëve. Me urdhër të prokurorit i dyshuari pas intervistimit është liruar në procedurë të rregullt”, thuhet në njoftimin.